


REPUBLIKA E SHQIPËRIE  
MINISTRIA E SHËNDETSISË




QENDRA KOMBËTARE  
URGJENCËS MJEKËSORE



**127/112**

**Urgjenca Mjekësore**



## Çfarë është 127/112?

- **127/112** është nr i referimit për të gjitha rastet e kërkesës për ndihmë mjekësore si në rastet e sëmundjeve të papritura dhe në aksidentet e çdo lloji.
- **127/112** lidh qytetarin me Njësinë e Koordinimit (QKUM) e cila pasi merr telefonatën dërgon personelin e specializuar dhe ambulancën e përshtatshme në varësi të situatës dhe kërkesës për ndihmë mjekësore.
- **127/112** është një nr falas dhe pa pagesë, aktiv 24 orë në 24

## Kur të telefononi 127/112

- Në të gjitha situatat kur mund të ketë rrezik për jetën ose lëndime të rënda fizike, si në rastin e sëmundjeve të menjëhershme, traumave, helmimeve, djegieve, mbytjeve, aksidenteve (në ambientet e shtëpise, rrugore, bujqësore, industriale, në punë etj).

## Si të telefononi në numrin 127/112

- Formoni nr **127/112**
- Përgjigjuni me qetësi pyetjeve të bëra nga operatorët
- Jepni një nr kontakti
- Jepni arsyen e telefonatës (sëmundje, aksidente etj)
- Jepni adresën e plotë ku ndodhet i sëmuri (qytet, fshat, rrugë, kryqëzim, pallat, institucion dhe çdo pikë referimi pranë jush)
- Jepni numrin e personave të përfshirë
- Përshekruani gjendjen e pacientit: përgjigjet, merr frymë, a ka gjakrrjedhje etj
- Përshekruani situata të veçanta: fëmijë i vogël, grua shtatzënë, persona me sëmundje të njohura si: sëmundjet e zemrës, astma, diabeti, epilepsi.
- ▶ Biseda zhvillohet me zë të qartë dhe duhet të jepen përgjigjet sa më të plota në mënyrë që operatori të arrijë në analizimin e plotë të situatës
- ▶ **Kujdesuni që nr i kontaktit të jetë i disponueshëm për të krijuar mundësinë e komunikimit në çdo kohë me ekipin tonë.**

## Në pritje të shërbimit të urgjencës

### Çfarë duhet të bëni:

- Siguro veten
- Lironi me kujdes rrobat e ngushta (rrip, kravatë etj) për të lehtësuar frymëmrrjen
- Mbuloni pacientin kur temperaturat janë të ulta
- Jepini siguri dhe inkurajoni pacientin
- Në rast aksidenti, mos pengoni ardhjen e ekipit mjekësor si dhe sinjalizoni kalimtarët për rrezikun
- Telefononi sërish **127/112** nëse gjendja e pacientit përkeqësohet

### Çfarë nuk duhet të bëni

- ◆ Mos u frikësoni. Ruani qetësinë
- ◆ Mos lëvizni të traumatizuarin
- ◆ Mos i jepni ushqim ose pije
- ◆ Mos i jepni ilaçe pa u konsultuar me mjekun

### Kur nuk duhet telefonuar 127/112

- Për shërbimet jo-urgjente si: vizitat e planifikuara, daljet nga spitali, transferimet ndër-spitalore
- Për trajtim mjekësor të specializuar
- Për informacione me natyrë social-shëndetësore si: orari i shërbimeve, planifikim vizitash shëndetësore, ekzaminimet ose testet diagnostike

**Adresa:** Rruga Lord Bajron, Nr.70 Tiranë

**Web:** <http://www.urgjenca.gov.al>

**Email:** [promocion@urgjenca.gov.al](mailto:promocion@urgjenca.gov.al)